LIGJ
Nr.10 356, datë 16.12.2010

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË TURQISË PËR NJËSINË SHQIPTARE QË OPERON NËN KOMANDËN E FORCËS TURKE NË AFGANISTAN, BRENDA FUSHËS SË VEPRIMIT TË OPERACIONEVE TË FORCËS NDËRKOMBËTARE TË NDIHMËS PËR SIGURINË (ISAF)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Turqisë për njësinë shqiptare që operon nën komandën e forcës turke në Afganistan, brenda fushës së veprimit të operacioneve të Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë (ISAF).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6827, datë 27.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLL

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË TURQISË NË LIDHJE ME NJËSINË SHQIPTARE QË OPERON NËN KOMANDËN E FORCËS TURKE NË AFGANISTAN BRENDA FUSHËS SË VEPRIMIT TË OPERACIONEVE TË FORCËS NDËRKOMBËTARE TË NDIHMËS PËR SIGURINË (ISAF)

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim referuar si “Palët”),

Në zbatim të rezolutave 1386 (2001), 1413 (2002), 1444 (2002), 1510 (2003), 1563 (2004), 1623 (2005), 1662 (2006), 1707 (2006), 1776 (2007),1833 (2008) e 1890 (2009) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara;

Duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes Ushtarake Teknike ndërmjet Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë (ISAF) dhe Administratës së Përkohshme të Afganistanit të datës 4 janar 2002;

Duke mbajtur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktin e Atlantikut të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (NATO SOFA), të bërë në Londër më 19 qershor 1951;

Duke qenë të sigurt se njësia shqiptare, e cila operon në Afganistan nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan (ATTF), do të ndihmojë në forcimin e miqësisë dhe bashkëpunimit

ndërmjet Palëve, kanë rënë dakord mbi dispozitat në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij protokolli është të përcaktojë parimet dhe detyrimet në lidhje me njësinë shqiptare që operon nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan brenda fushës së veprimit të Operacioneve të Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë.

Neni 2
Fusha e veprimit

Ky protokoll përcakton hollësitë e mbështetjes dhe bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

Neni 3
Autoritetet

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij protokolli janë Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Republikës së Turqisë.

Neni 4
Përkufizime

1. "ISAF" nënkupton forcën ndërkombëtare që kryen operacione të udhëhequra nga NATO-ja në Afganistan, në përputhje me rezolutat 1386 e në vijim të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
2. "Komanda e Forcës Turke në Afganistan (ATTF)" nënkupton autoritetin që drejton personelin civil/ushtarak, të caktuar ndaj saj në Afganistan brenda fushës së veprimit të ISAF-it.
3. "Njësia shqiptare" nënkupton anëtarët civilë/ushtarakë të Forcave të Armatosura Shqiptare që shërbejnë nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan.
4. "Forca Shqiptare e Manovrës" nënkupton forcën luftarake shqiptare që do të operojë në Afganistan nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan.
5. "Oficer i lartë shqiptar" nënkupton oficerin, i cili ka gradën më të lartë në njësinë shqiptare që do të operojë në Afganistan nën Komandën e Forcës Turke në Afganistan.
6. "Disiplinë" nënkupton bindjen e pakushtëzuar ndaj urdhrave dhe komandantëve, si edhe përputhshmërinë absolute me ligjin e eprorëve dhe vartësve.
7. Misioni duhet të plotësojë kërkesat e shërbimit dhe t'u nënshtrohet ndalimeve të tij.
8. "Urdhër" nënkupton shprehjen me shkrim, me gojë apo në formë tjetër të kërkesës dhe ndalimit rreth shërbimit.

Neni 5
Parimet dhe përgjegjësitë

1. Njësia shqiptare brenda kuadrit të autoritetit të dhënë nga Komandanti i Forcës Turke në Afganistan (ATTF), mund të vihet në përdorim individualisht, e ndarë, me elemente, ose si një e tërë kur kërkohet në zonat që gjykohet e përshtatshme nga komandanti i Forcës Turke të Batalionit të Motorizuar të Këmbësorisë.
2. Personeli i njësitë shqiptare do të përmbushë misionin e tij nën kontrollin operacional të komandantëve të ATTF-së dhe të Forcës të Batalionit në mbështetje të operacioneve të ISAF-it. Në nivel vendi, njësia shqiptare do të jetë nën autorizimin e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.
3. Shtirja dhe hollësitë e detyrave që duhen përmbushur nga njësia shqiptare, do të

përcaktohen nga vetë Palët ose nga personat e autorizuar prej tyre. Përmbushja e këtyre detyrave do të bëhet në përputhje me "Rregullat e angazhimit" (ROE), të përcaktuara për territorin e misionit në bashkërendim me Komandantin e Forcës Turke në Afganistan.

Neni 6
Çështje që lidhen me personelin

1. Forca Shqiptare e Manovrës do të vendoset si një forcë e përbërë nga personel kontingjent dhe personel ushtarak të përcaktuar nga të dyja Palët e që do të operojë nën komandën e ATTF-së.

2. Personeli i njësisë shqiptare do të mbajë gradat, simbolet dhe flamurin që i përket Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Çështje si pushimet dhe ndryshimi i detyrës për personelin e njësisë shqiptare do të kryhen në përputhje me parimet, të cilave i nënshtrohet edhe personeli i Komandës së ATTF-së.

4. Personeli i njësisë shqiptare do t'i nënshtrohet të Drejtës Ushtarake të Shqipërisë. Sidoqoftë, Komandanti i ATFF-së dhe Komandanti i Batalionit Turk të Këmbësorisë do të përgatitin një "raport vlerësimi" mbi personelin e sipërpërmendur dhe do t'ua përcjellë atë autoriteteve përkatëse ushatrake në Shqipërisë përmes Zyrës së Atasheut të Republikës së Turqisë në Tiranë.

5. Oficeri i Lartë Shqiptar do të jetë përgjegjës për disiplinën e njësisë shqiptare.

6. Në qoftë se komandanti i ATTF-së do të dojë të ndryshojë cilindo nga personeli në njësinë shqiptare për shkak të mungesës së disiplinës, për arsye shëndetësore apo të tjera, personeli përkatës do të zëvendësohet menjëherë.

Neni 7
Parimet logjistike

1. Transportimi i personelit të njësisë shqiptare, që do të shërbejë në Afganistan ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri do të përballohet nga Pala turke.

2. Armët dhe municionet e njësisë shqiptare do të sigurohen nga Pala shqiptare. Pas mbarimit të misionit, të gjitha pajisjet e dhëna nga Pala turke do të kthehen.

3. Personeli i njësisë shqiptare që shërben në Afganistan do të përdorë mjediset e Komandës së ATTF-së për të plotësuar nevojat e tyre për komunikim. Komunikimi zyrtar do të sigurohet pa pagesë. Sidoqoftë, shpenzimet vetjake për komunikim do të përballohen nga personeli.

4. Personeli i njësisë shqiptare që shërben në Afganistan do të përfitojë nga shërbimet shëndetësore, duke u bazuar mbi të njëjtat parime, si edhe personeli i Komandës së ATTF-së.

5. Në rast gjendje krize, në operacione ose në zonën e operacioneve, nëse është e nevojshme që të evakuohen forcat, Pala turke do të sigurojë evakuim për personelin e njësisë shqiptare.

6. Në rast të plagosjeve të rënda dhe humbjes së jetës, Pala turke do të sigurojë transportim për në Tiranë për personelin e njësisë shqiptare.

Neni 8
Çështjet ligjore

1. Personeli i njësisë shqiptare do t'i nënshtrohet gjatë gjithë kohës dhe në çfarëdo rrethanash ekskluzivisht elementëve të juridiksionit të autoriteteve të tyre kombëtare për shkeljet civile, administrative, penale ose disiplinore dhe këto raste do të administrohen nga Policia Ushtarake Shqiptare. Në çdo rast, do të njoftohet menjëherë Komandanti i ATTF-së.

2. Pretendimet ndërmjet Palëve do të trajtohen në përputhje me parimet e përcaktuara në

nenin 7 të NATO-SOFA.

Neni 9
Çështjet financiare

1. Sigurimet financiare: Shpenzimet ditore të njësisë shqiptare në lidhje me ushqimin dhe shërbimin do të përballen nga Pala turke.

2. Pala shqiptare do të jetë përgjegjëse për dëmshpërblim të dëmeve dhe humbjeve të shkaktuara nga personeli i njësisë shqiptare.

3. Pala turke do të paguajë një dietë ditore për personelin e njësisë shqiptare si vijon: 24 dollarë amerikanë për oficerët, 22 dollarë amerikanë për NCO dhe për personelin civil, si edhe 5 dollarë amerikanë për çdo ushtar.

4. Përveç ushqimit dhe strehimit, asnjë shumë nuk do t'i paguhet personelit shqiptar gjatë qëndrimit të tyre në Turqi.

Neni 10
Çështjet e stërvitjes

Njësia shqiptare do të marrë pjesë në programet stërvitore në lidhje me operacionin ISAF nga Komanda e ATTF-së gjatë detyrave të saj në kuadrin e ISAF-it.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Cilado mosmarrëveshje mbi interpretimin ose zbatimin e këtij protokolli do të zgjidhet vetëm përmes këshillimit ndërmjet Palëve dhe nuk do t'i referohet asnjë pale të tretë apo gjykate ndërkombëtare apo arbitrazhi ndërkombëtar.

Neni 12
Ndryshimi dhe rishikimi

Cilado Palë mund të propozojë me shkrim që të ndryshohet ose rishikohet ky Protokoll, siç mund të kërkohet. Në këtë rast, negociatat do të fillojnë të paktën brenda 30 ditëve nga data e njoftimit me shkrim. Nëse Palët nuk kanë asnjë rezultat nga negociatat brenda 30 ditëve, ky protokoll mund të përfundojë sipas dispozitës së nenit 13 (kohëzgjatja dhe përfundimi).

Neni 13
Kohëzgjatja dhe përfundimi

Ky protokoll do të mbetet në fuqi gjatë gjithë periudhës së kohës në të cilën njësia shqiptare do të kryejë misione bashkërisht me ATTF-në gjatë gjithë operacionit të ISAF-it. Ky protokoll do të përfundojë automatikisht kur të mbarojë misioni i ISAF-it ose në ditën e 30-të pas mbërritjes së njoftimit të përfundimit nga njëra Palë te Pala tjetër. Veç kësaj, Palët kanë të drejtë të përfundojnë këtë protokoll në çdo kohë me pëlqimin e tyre të ndërsjellë. Pretendimet e ndërsjella për dëmshpërblime të Palëve dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga problemet që dalin gjatë gjithë veprimtarisë, përjashtohen nga ky qëllim.

Neni 14
Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë me anë të të cilit Palët do të informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për plotësimin e procedurave të ratifikimit sipas legjislacioneve përkatëse.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të këtij protokolli "Protokolli ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë në lidhje me Forcat Ushtarake Shqiptare që operojnë nën Komandën Turke brenda fushës së veprimit të Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë në Afganistan", i nënshkruar në Tiranë më 3 nëntor 2003, do të përfundojë.

Neni 15

Teksti dhe nënshkrimi

Bërë më 30.7.2010 në dy kopje origjinale, secila në shqip, turqisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha tekstet njëlloj të barasvlershme. Në rast mosmarrëveshjesh në lidhje me interpretimin, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Vladimir Avdiaj
Kolonel
Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në SHPFA

Për Qeverinë e Republikës së Turqisë

Saim Bağci
Hv.Svn.Kur.Alb
Tiran As.Atş.ve As.Işb. ve Koor Krl.Bşk